

biznes EUROPA

BULETIN MUJOR, KORRIK 2007 • INSTITUTI I STUDIMEVE NDERKOMBETARE (AIIS) • TEL. +355 4 24 88 53 • e-mail: aiis@aiis-albania.org

Strategjia e futjes në treg në një ekonomi globale në ndryshim



PENGESAT TREGTARE NE EKONOMINE MODERNE GLOBALE

Pengesat me të cilat përballen eksportuesit e BE-së mund të kategorizohen si më poshtë:

1. Pengesat tarifore. Megjithëse këto kanë pësuar ndryshime nga takimet e njëpasnjëshme tregtare shumëpalëshe, tarifatat e larta përbëjnë akoma probleme për eksportuesit e BE-së.
2. Procedurat e vështira doganore për importin, eksportin dhe transitin.
3. Rregullat e panevojshme teknike, standardet dhe pajtimi me procedurat e vlerësimit.
4. Kufizimet sanitare dhe fito-sanitare që nuk justifikohen nga rregullat ekzistuese të OBT-së mbi shëndetin dhe kufizimet për sigurinë.
5. Kufizimet ndaj lëndëve të para, sidomos praktikata kufizuese të eksportit që ngrenë çmimet për mallra kryesore minerale dhe metalet.
6. Mbrojtja e dobët e të drejtave të pronësisë intelektuale përfshi treguesit gjeografikë, çështje të rëndësishme të zbatimit dhe detyrimit.
7. Pengesat tregtare në shërbime të tilla si markat e huaja të pronësisë, detyrimet në sipërmarrjet e përbashkëta dhe trajtimet diskriminuese.
8. Pengesat në investimet e huaja direkte të tilla si përjashtimi i investitorëve të huaj nga sektorë të caktuar, kufizimet sasore në investime apo pronësi dhe trajtimet diskriminuese.
9. Rregullat kufizuese qeveritare të prokurimit që pengojnë kompanitë e BE-së nga paraqitja e ofertave në mënyrë efektive për kontratat publike në vendet e treta.
10. Përdorimi i padrejtë i instrumenteve të mbrojtjes tregtare nga vendet e treta.
11. Përdorimi i padrejtë i ndihmës shtetërore dhe subvencioneve nga vendet e treta nga vendet e treta në një mënyrë që krijon pengesa për hyrjen në treg.

AIIS

ME MBESHTETJEN
E DELEGACIONIT
TE KOMISIONIT
EUROPIAN
NE TIRANE



Për informacione
dhe pyetje vizitoni
qendrën e kërkimeve
dhe të informimit
në adresën:

www.aeuric.org

Kuadri i politikës globale europiane të komisionit të BE-së vë në dukje se politika tregtare e Europës duhet të bëhet pjesë integrale e një qasjeje më të madhe ndaj reformave ekonomike dhe konkurrencës. Një ekonomi më e fortë brenda BE-së do të thotë që Europa të bëhet më konkurruese jashtë. Ne kemi nevojë të hapim tregjet dhe të krijojmë mundësi të reja për tregtinë dhe të sigurohemi që kompanitë europiane të jenë të afta të konkurrojnë me ndershmeri në ato tregje.

Në mënyrë më specifike, Europa Globale e konsideron përmirësimin e futjes në treg jashtë Europës për eksportuesit europianë si një pikë kyçe të shtimit të konkurrencës europiane në tregjet globale, për rritje dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ndërkohë që rregullimi i tregtisë është i domosdoshëm, ai duhet bërë në një mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, për të qenë sa më pak që të jetë e mundur kufizues për tregtinë. Përdorimi efektiv i të gjitha instrumenteve politikë në dispozicion për të zvogëluar dhe për të hequr pengesat ndaj tregtisë është në themel të punës së Komisionit Europian. Strategjia e Komisionit Europian për futjen në treg është përqendruar në forcimin e marrëveshjeve të hapura tregtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, në futjen efektive në treg të eksportuesve të BE-së në vendet e treta, pas shqyrtimit të pengesave tregtare të cilat ose pengojnë hyrjen në treg ose e bëjnë atë më të vështirë, më të shtrenjtë ose më të pavolitshëm. Kjo u siguron eksportuesve informacion mbi kushtet e futjes në treg në vendet e treta për të tregtuar mallra e shërbime dhe krijon një kuadër të kufizimit të pengesave në vendet e treta për tregtimin e mallrave dhe shërbimeve, të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe investimeve.

Përse një rishikim tani?

Gjatë dhjetë vjetëve të fundit, në Bashkimin Europian, fokusi i shqetësimeve për futjen në treg ka ndryshuar në mënyrë të dukshme. Takimet e njëpasnjëshme shumëpalëshe tregtare dhe liberalizimi i njëanshëm ka hequr nivelet tarifore, sidomos në botën e zhvilluar. Ndërkohë që tarifatat mbeten



STRATEGJIA E RE E FUTJES NE TREG

Do të heqë pengesat e tregtisë dhe do të hapë tregje të reja për produktet



një çështje e rëndësishme, pengesat jo tarifore dhe kufizimet e tjera rregulluese 'pas kufijve' janë bërë gjithnjë e më shumë të rëndësishme në përcaktimin e hyrjes së

eksportuesve të BE-së në tregjet e vendeve të treta.

Legjislacioni në shumë vende të treta tanimë përfshin shumicën e kërkesave të OB-T-së në çështje të tilla si tarifatat, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe pengesat teknike ndaj tregtisë. Megjithatë shtrirja e rregullave të OB-T-së nuk ka ecur plotësisht në një hap me vargun e madh të pengesave tregtare dhe njoftimet për pengesat tregtare të OB-T-së në komitetin e tregtisë, sa vjen e më shumë, nuk janë në shkëlqje të disiplinave ekzistuese të OB-T-së. Në fusha të tilla si taksat e eksportit, mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, certifikimi i produkteve, prokurimi publik, investimet dhe rregulloret tregtare të shërbimeve, rregullat shumëpalëshe të OB-T-së nuk pasqyrojnë plotësisht kompleksin e problemeve me të cilat përballen eksportuesit.

Madje edhe atje ku rregullat e OB-T-së ekzistojnë, çështja e forcimit të këtij legjislacioni mbetet në shumë raste një çështje reale. Kompanitë e BE-së raportojnë se

problemet e tyre tani gjithnjë e më shumë po përqendrohen në zbatimin e detyrimeve ekzistuese. Çështja e mbrojtjes së pronësisë intelektuale është një problem kyç ku moszbatimi i detyrimeve ekzistuese është një problem në rritje për eksportuesit e BE-së.

Kapërcimi i pengesave jo tarifore dhe rregulluese si dhe zbatimi i angazhimeve ekzistuese në këto fusha është një punë e ndërlikuar që qëndron në themel të politikës tregtare moderne. Ajo do të përcaktojë gjithnjë e më shumë punën e Komisionit Europian për hyrjen në treg.

Një studim i kohëve të fundit i kryer nga konsulentët të jashtëm vinte në dukje se shumë eksportues të BE-së besojnë se strategjia e futjes në treg duhet të rishikohet dhe të ripërtërihet me qëllim që të rrisë efektivitetin e saj. Dhjetë vjet pas hartimit të kësaj strategjie një rishikim i saj do të na mundësonte të siguroheshim se ajo i përgjigjet si duhet një ekonomie globale që ndryshon me shpejtësi.

■ **BE-ja propozon politika të reja për të eliminuar diskriminim e vazhdueshëm në vendin e punës**

Pagë e barabartë për punë të barabartë



Gratë fitojnë më pak se burrat, rreth 15 për qind më pak, për të qenë të saktë. Shifra ka mbetur e fiksuar që dekadën e kaluar, pavarësisht rritjes së numrit të grave në vendet e punës. Në 8 milion vendet e punës të krijuara në BE që prej vitit 2000, 6 milion janë të zëna nga gratë. Duke shtuar këtu edhe faktin që rreth 60 për qind e të diplomuarve nëpër universitete janë femra, duket e çuditshme kjo ngecje në vend e gjërave. Kjo është një situatë absurde që duhet të ndryshojë, - deklaroi komisioneri për punësimin Vladimír Špidla, në një njoftim të lëshuar me rastin e një raporti sesi BE-ja mund të mbushë këtë boshllëk mes gjinive. Sipas tij kjo nuk është një situatë e thjeshtë, shkaqet janë të shumta, komplekse dhe shpesh të fshehura. Gratë janë më shumë të predispozura të bëjnë punë të papaguara apo me kohë të pjesshme, ndërsa të tjerat janë të punësuar kryesisht në sektorë me profil femëror dhe në shkallë të paguara pak. Përgjithësisht, aftësitë të shoqëruara me femrat, janë më pak të vlerësuara sesa ato të meshkujve. Punët që kërkojnë të njëjtat kualifikime kanë prirjen të paguhen më pak kur sektori është i dominuar nga femrat. Kështu për shembull dadot paguhen më pak

se mekanikët e makinave, arkëtarët më pak se punëtorët e mirëmbajtjes në shtëpi dhe infermieret më pak se policët. Për shkak të përgjegjësisë familjare, gratë e kanë më të vështirë të ngjisin shkallët e karrierës dhe të vendosen në poste drejtuese, edhe pse femrat drejtuese shikohen si në të suksesshme në shumë shoqëri, rreth 77 për qind. Kjo ka rezultuar sipas një sondazhi të publikuar në fillim të vitit. BE-ja ka identifikuar 4 drejtime kryesore të cilat mund të shërbejnë në zvogëlimin e këtij diskriminimi:

• *Aplikimi i ligjeve aktuale me më shumë efikasitet*

• *Integrimi i masave të ndryshme për politikatat e punësimin kombëtar si edhe të përdorin plotësisht fondin evropian për politikatat sociale*

• *Promovimi i pagave të barabarta si pjesë e përgjegjësisë sociale të punonjësve*

• *Mbështetja e shkëmbimit të mallrave nëpërmejt Evropës*

Për një rezultat sa më efektive, BE-ja beson se duhet të përfshihen të gjitha partitë dhe të identifikohen faktorët. Boshllëku i pagave është nënvizuar gjithashtu hartën e barazisë gjinore, që ka për qëllim ta bëjë këtë çështje kryefjalë të shekullit XXI.



GJERMANIA

kërkon të punësojë inxhinierë dhe vjelës sezonalë

■ **Lulëzon ekonomia e superfuqisë evropiane, por ka krizë për fuqi punëtoare**

Kur në vitin 2004, Polonia dhe disa vende të tjera lindore aderuan në Bashkimin Evropian, Gjermania ishte nga ato vende që ngritën mure të larta për pengimin e ardhjes së punëtorëve nga këto vende në Gjermani, me qëllim ruajtjen e tregut gjerman të punës. Në Gjermani nuk kishte askush dëshirë që punëtorë nga vendet e reja të BE-së të vinin dhe të ofronin shërbimet e tyre, kundrejt një shpërblimi page të ulët. Koniunktura po lulëzon, firmat gjermane po punësojnë sërish, madje në disa degë të ekonomisë ka mungesë të fuqisë punëtoare. Kërkohen, para së gjithash, inxhinierë të kualifikuar, por edhe vjelësit sezonalë mungojnë. Në Ministrinë gjermane të Punës, për këtë arsye, ekziston ideja për heqjen e kufizimeve për punëtorët nga Lindja para vitit 2009. Kjo duhet të bëhet vetëm në raste të caktuara, thotë eksperti për punën e socialdemokratëve, Klaus Brander në televizionin e parë gjerman, "ARD": "Po që se e lejojmë lirinë e plotë, atëherë ne presim futjen e ligjeve për pagën minimale, me qëllim që të mos biem në konkurrencën e dumpingut në kurriz të punëmarrësve dhe punëmarrësve të këtuashëm".

Hapjen e shpejtë të tregut të punës e mirëpret ekonomia. Martin Vansleben, nga Dhoma Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë, mendon se është urgjente ardhja e të diplomuarve dhe forcave të kualifikuara nga Evropa Lindore: "Kjo, me qëllim që në vend të arrijmë të kryejmë ato porosi që arrijmë t'i sigurojmë dhe që mund t'i siguronim. Si pasojë, do të hapeshin vende të reja pune edhe këtu në Gjermani. Kjo është jo vetëm logjike, por edhe e provuar nga ana empirike. Shikoni Anglinë apo Suedinë, ato po e bëjnë këtë gjë më parë. Ne vetëm ankojmë dhe bllokojmë vetveten". Por sindikatat e shohin këtë hapje me sy jo të mirë, ato i tremben uljes së pagave. Vilhelm Adami nga Shoqata e Sindikatave Gjermane shprehet se është thjesht dredhi e firmave, shpallja e mungesës së fuqive të kualifikuara; ato, në të vërtetë, shpresojnë ardhjen e fuqisë së lirë punëtoare nga jashtë: "Ne kemi, si edhe më parë, një papunësi të lartë. Së dyti, fuqia e huaj punëtoare shfrytëzohet, shpesh kësaj kategorie i duhet të punojë në kushte jo të mira krahasuar me fuqinë punëtoare gjermane. Ne mendojmë se ne duhet të bëjmë sa më shpejt detyrat tona të shtëpisë, para se të shtrojmë kërkesën për hapjen e tregut të punës në vitin 2009". Detyrat e shtëpisë: Me këtë, eksperti Adami ka parasysh jo vetëm çështjen e pagës minimale, por edhe shkollimin e vazhdimin e kualifikimit të gjermanëve në vend. Vetëm kështu do t'i kundërpërgjigjemi mungesës së fuqisë së kualifikuara punëtoare: "Vetë ekonomia, nuk ka arritur të përgatisë rininë aq sa duhet dhe për këtë arsye është e nevojshme një ofensivë arsimimi. Dhe ne duhet të bëjmë më shumë për të huajt që janë këtu. Po që se evitohen këto probleme, tregu i punës mund të hapet vetvetiu". Brenda qeverisë gjermane nuk ka ende një qëndrim të unifikuar për këtë çështje. Pritet që hapja e tregut gjerman të punës ndaj vendeve lindore të BE-së, të jetë temë diskutimi në mbledhjen e kabinetit gjerman, në gusht.

■ **Greçia pret më tepër turistë këtë vit, ndërsa rreket të prishë dyndjen e vizitorëve "vetëm në verë"**

Potenciali turistik i Greçisë ndez optimizëm



ATHANAS PAPANDROPULOS, *Athinë*


Ministrja greke e turizmit Fani Palli-Petralia ishte qartazi optimiste kur kohët e fundit foli për numrat në rritje të turizmit që pritëshin këtë verë. Me gjithë të nxehtit rekord, Greçia mund të shohë deri në 16 milion vizitorë këtë vit. "Qeveria është e vendosur të rritë fluksin e turizmit me 20% në 2007. Ky objektivi është ambicioz por jo i pamundshëm. Ne jemi të sigurt se duke rritur përpjekjet tona, mund t'ia dalim," tha ministrja. Afërsisht 15 milionë turistë vizituan Greçinë verën e shkuar. Numri i ardhjeve këtë vit pritet të rritet me 7% sipas Institutit për Studimin e Parashikimin e Turizmit. Santorini, një nga 100 ishujt e Egjeut, pret 1 milion vizitorë, 20% më shumë se vitin e shkuar pavarësisht nga fakti që një anije udhëtimi u mbyt në brigjet e tij në mars. Nga sa thuhet, të paktën një e treta e ardhjeve këtë vit do të jetë nga Britania e Gjermania, tregjet më besnike ndaj Greçisë. Por rritjet më të mëdha priten nga Shtetet e Bashkuara dhe Rusia, me ardhje përcaktuar të rriten respektivisht me 50% dhe 20%, apo 1.7 milion turistë. Një rritje e tregut pritet gjithashtu nga banorët e vendeve të reja

anëtare të BE në Ballkan si dhe nga Kina. "Greçia nuk është vetëm një destinacion popullor, por një i tillë i preferuar, gjë që është një dallim i madh," tha Palli-Petralia. Turizmi është një industri e madhe në Greçi, llogaritur për një të pestën e PKB-së së vendit dhe një në pesë vende pune. Vitin e shkuar, turizmi prodhoi 11 miliard euro të ardhura, një rekord që pritet të thyhet këtë vit me gjithë konkurrencën e ashpër nga rivalët e Mesdheut si Spanja, Turqia dhe Egjipti dhe konkurrentët e rinj si Kroacia e Mali i Zi. Por kujtimet e një vithisje të turizmit që filloi pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 dhe vazhdoi deri në Olimpiadën e Athinës 2004, nuk janë shuar kështu që qeveria ka marrë hapa të parandalojë një përsëritje. Një shtysë është në proces për të zgjeruar sezonin tradicional maj-tetor dhe të mbështesë infrastrukturën e turizmit të vendit. Përvoja ka nënvizuar nevojën për të zhvilluar dhe nxitur format alternative me cilësi të lartë të turizmit. Kjo shërben si një mënyrë për të kapërcyer vartësinë e vendit nga muajt e verës që janë të preferuar nga shumica e vizitorëve, pavarësisht nga fakti se moti i butë mbizotëron për 8-10 muaj të vitit. Gjithashtu, mbështetja e posaçme në udhëtimet me paketa pushimesh e ka vlerësuar anëtarin e eurozonës, Greçinë jashtë fundit të

poshtëm të tregut të turizmit, ku konkurrenca nga rivalët rajonalë "më të lirë" nga Ballkani, Adriatiku, Egjeu dhe Mesdheu juglindor është intensifikuar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Gjatë nja dy viteve të fundit, Greçia ka qenë e vetmja nga destinacionet e mëdha të turizmit të eurozonës që nuk ka përmirësuar pjesëmarrjen e vet. "Është e pafalshme për një vend si yni, me një klimë të veçantë, një kulturë të pasur dhe peizazhe të ndryshëm ishullorë, të kemi një periudhë turizmi prej vetëm katër apo pesë muajsh," tha ministrja e turizmit. "Objektivi ynë për Greçinë është që ajo të bëhet një destinacion gjatë gjithë vitit. Ne mund ta arrijmë atë duke tërhequr turistët me të ardhura të larta që mund të përballojnë më tepër se kombinimi det-diell-pamje dhe ne mund t'ua ofrojmë këtë." Palli-Petralia dhe zyrtarë të tjerë të industrisë së turizmit besojnë se një potencial më i madh i pashfrytëzuar për zhvillimin ekziston në komplekset e vendpushimeve të integruara, turizmit shëndetësor: hidro-masazhet, sallonet e bukurisë dhe turizmi rezidencial, kazinotë dhe fushat e golfit. Këto forma të turizmit nuk varen nga stina dhe valuta apo ciklet ekonomike nuk ndikojnë mbi to. Ekspertët thonë se larmia është kyçi

Hyn në fuqi Marrëveshja e CEFTA-s për vendet e Europës Juglindore

Më 26 korrik hyri në fuqi Marrëveshja e Tregtisë së Lirë mes vendeve të Evropës Juglindore, sipas të cilës këto shtete do të eksportojnë te njeri-tjetri mallra pa doganë. Nga kjo datë, Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Moldavia dhe Mali i Zi do të eksportojnë te njeri-tjetri mallra pa doganë. Kjo bëhet e mundur në bazë të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Vendeve Evropës Qendrore (CEFTA), që hyri në fuqi dhe që është ratifikuar nga vendet e sipërpërmendura, mes të cilëve edhe vendi ynë. Së shpejti pritet që marrëveshja të ratifikohet edhe nga vendet e tjera, si Serbia, Mali i Zi dhe Kroacia. Dita e 26 korrikut vlerësohet si shumë e rëndësishme për vendet respektive, pasi bëhet e mundur që prodhimet e vendeve nënshkruese të eksportohen pa doganë në këto vende dhe në këtë mënyrë marrëveshja e CEFTA-s hap perspektivën e bizneseve vendore, hap tregje të reja që do të çojnë në rritjen e investimeve në këto vende.



Takimi i katërt BE - Këshilli i Stabilizim Asociimit të Maqedonisë

Takimi i katërt midis Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit të Maqedonisë u mbajt më 24 korrik

2007. Takimi u kryesua nga zoti Antonio Milososki, ministër i Punëve të Jashtme të Maqedonisë. Presidenca e Këshillit Evropian përbëhet nga zoti Manuel Lobo Antunes, sekretari i Shtetit për Çështjet Evropiane të Portugalisë, zoti Jan Trzeczinski, zëvendës drejtor i përgjithshëm i drejtorisë së përgjithshme të komisionit për zgjerimin dhe zoti Dimitrij Rupel, ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Sllovenisë, si edhe përfaqësuesi special dhe kryetar i delegacionit të Komisionit Evropian në Maqedoni, Ervvan Fouéré. Këshilli i SA-së, iu referua takimit të dhjetorit të 2006 të: Këshillit Evropian, ku u theksua se statusi i kandidatit që i jepej Maqedonisë ishte si njohje e reformave të arritura deri atëherë dhe njëkohësisht i bëhej thirrje shtetit të përshpejtonte reformat me qëllim ecjen më përpara në rrugën e asociimit. BE-ja gjithashtu theksoi se raporti i ardhshëm i komisionit mbi progresin do të shërbejë si një bazë për rishikimin e progresit të arritur për MSA-në. Nga ana e saj edhe Maqedonia është zotuar për avancimin e reformave me qëllim hapjen sa më shpejt të jetë e mundur të procesit të asociimit. Këshilli i SA-së rishikoi zhvillimet e lidhura me kriteret politike. BE-ja mirëpriti nifillimin e dialogut politik, si një hap kryesor për forcimin e institucioneve demokratike dhe të qëndrueshme.



Antonio Milososki

BE-ja vazhdoi të theksonte nevojën e një dialogu politik të vazhdueshëm dhe konstruktiv, si një çështje thelbësore dhe me rëndësi kombëtare. Këshilli theksoi gjithashtu se duhet të ndërmerren reforma më efektive në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit, duke thënë se kjo marrëveshje është thelbësore për procesin e integritimit në BE. Gjithashtu u rishikuan edhe reformat gjyqësore, duke bërë thirrje për përpjekje të vazhdueshme për të siguruar një zbatim të plotë. BE-ja vlerësoi progresin e arritur deri tani sidomos për sa i përket hyrjes në fuqi të ligjit për policinë. U vlerësuan gjithashtu edhe politikat e ndërmarrja në luftën kundër korrupsionit dhe rezultatet e arritura në këtë fushë, por u theksua gjithashtu se vetëm një përkushtim real politikës do të kishte efektin e

dëshiruar në luftën kundër këtij fenomeni gjerësisht të përhapur. Këshilli i SA-së i kushtoi gjithashtu rëndësi progresit në administratën publike dhe në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Në vlerësimin e Këshillit të SA-së ishte edhe lehtësimi i regjimit të vizave, i cili pritet të hyjë në fuqi së shpejti. Për sa i përket kriterëve ekonomike, Këshilli vlerësoi progresin e arritur në drejtim të përmirësimit të klimës së investimeve dhe biznesit, njëkohësisht edhe stabilitetin e vazhdueshëm makroekonomik dhe të disiplinës fiskale. Por BE-ja u shpreh e shqetësuar për sa i përket nivelit të lartë të papunësisë, duke inkurajuar qeverinë të forcojë përpjekjet për përmirësimin e tregut të punës dhe të kërkojë reforma të tjera të cilat mund të kenë një ndikim

më pozitiv në ekonomi. Në lidhje me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Këshilli vërejti se Maqedonia ka arritur të zbatojë me sukses pjesën më të madhe të tyre. Në këtë kuadër u përmend progresi legjislativ në disa fusha si për shembull në dogana, transport, tregun e brendshëm, konkurrencën e ndershme, ku theksi u vu kryesisht në mbrojtjen e pronësisë intelektuale, konkurrencën në tregun e telekomunikacioneve, etj. Këshilli vlerësoi përfundimin e bisedimeve mbi një protokoll për MSA-së që merr parasysh hyrjen e Bullgarisë dhe Rumanisë në BE. Në takimin e 24 korrikut u përshëndet edhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit në kuadër të Programit për Zhvillim dhe Kërkime Teknologjike, duke e nxitur Maqedoninë t'i bashkohet programeve të tjera të këtij lloji të BE-së. Këshilli gjithashtu mbështeti kërkesën e bërë nga Maqedonia për t'iu bashkuar Komiteteve të Përbashkëta Këshilluese me Komitetin e BE-së për Ekonominë dhe Shoqërinë si edhe Komitetin e Rajoneve.

Këshilli gjithashtu shkëmbeu këndvështrime mbi zhvillimet e fundit në Ballkanin Perëndimor, duke vlerësuar angazhimin e Maqedonisë në bashkëpunimin në Evropën Juglindore. Një rëndësi e veçantë këtu iu kushtua pjesëmarrjes aktive të Maqedonisë në mbështetje të statusit përfundimtar të Kosovës, duke u rreshtuar në një krah me BE-në.

■ **Mali i Zi, shteti më i ri i botës, por tërheq gjithnjë e më tepër investitorë të huaj. Nëpërmjet turizmit, industrisë dhe pronës së patundshme, vendi renditet i treti në Evropë për investim për frymë të popullsisë**



Mali i Zi sheh një bum në investimet e huaja

Nga NEDJELJKO RUDOVIĆ
Podgoricë

Për shkak të ekonomisë së lirë të tregut dhe taksimit të ulët, Mali i Zi mori 505 milion euro në investime të huaja të drejtpërdrejta (FDI) vitin e kaluar. Sipas ekspertëve, FDI pritet të rritet në 850 milion euro këtë vit dhe të vazhdojë të rritet në mënyrë progresive. Me një popullsi prej 620,000 Mali i Zi është i treti në Evropë për investime për frymë, pas Estonisë dhe Republikës Çeke. "Rritja e investimeve tregon se ne kemi perspektivë të mirë në zhvillimin e ardhshëm. Ne llogarisim rreth 850 milion euro në FDI për këtë vit," tha CEO i Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Malit të Zi (MIPA) Petar Ivanović. "Investimet e huaja janë rritur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 2004." Investimet më të mëdha në vend vijnë nga sektori financiar. Fondet e reja të investimeve, bankat e mirënjohura dhe agjencitë e tjera financiare kanë hyrë në tregun e Malit të Zi. Sipas MIPA, turizmi është i dyti në sjelljen e

investimeve me ndërtimin e hoteleve të reja apo rristurimin e atyre ekzistues. Pasi ekonomia e Malit të Zi është kryesisht e bazuar në turizmin, një numër në rritje mysafirësh të huaj, rreth 450 mijë pritet të vizitojnë bregdetin malazez këtë vit, 30% më shumë se vitin e kaluar. Më tepër se gjysmë milioni turistë priten nga ish republikat jugosllave: Serbia, Bosnjë - Hercegovina dhe Maqedonia.

"Në qoftë se ne duam të zhvillojmë turizmin elitare, duhet të përmirësojmë sektorin tonë të shërbimit," tha Ivanović. Industria është e treta lidhur me tërheqjen e investimit dhe sektori i transportit vjen i katërti. Staatkraft me bazë në Norvegji është gati të investojë me një shumë fillestare prej 1.5 milion euro në sektorin e energjisë të Malit të Zi. "Plani është të ndërtohen hidrocentrale të rinj me synimin që Mali i Zi të bëhet një eksportues energjie. Përveç kësaj, një kompani me bazë në SHBA, Bechtel, planifikon të investojë në një infrastrukturë rugore nëpër Malin e Zi," tha Ivanović. Brenda vendit, disa thonë se ka shumë investime ruse. Federata Ruse ka blerë fabrikën e aluminit në

Podgoricë dhe një minierë boksitesh në Nikshiq. Megjithatë, sipas Ivanović, Mali i Zi nuk duhet ta frenojë lirinë e investimit për investitorët e huaj. "Frenimi i lirisë së investimit është diskriminim. Është e rëndësishme të kujtojmë se investitorët e huaj nuk kalojnë ligje, ata nuk janë në parlament, në qeveri dhe në agjencitë e saj. Ata nuk janë përgjegjës për rregullat," tha ai. Të gjitha investimet e mëdha në shtetin e ri pritet gjithashtu të tërheqin një tip financimi më personal. Duke përmirësuar infrastrukturën e zonës, me paratë që hidhen në rrugët, aeroportet dhe hekurudhat, shumë individë nuk po kërkojnë perspektivat e pronës së patundshme të vendit. Sipas një raporti javën e shkuar nga ekspertët e pasurive të patundshme të Colliers International, bumi i pronës në Malin e Zi është rritur deri në 400%, nxitur nga investitorë nga MB dhe Rusia. Kjo prijet konstante në investimin e pronës vjen pas një raporti nga Këshilli i Udhëtimit Botëror dhe Turizmit që tha se Mali i Zi pritet të bëhet ekonomia me rritje më të shpejtë të udhëtimit e turizmit në botë.

Bosnje dhe Hercegovina siguron kredi për të rindërtuar rrugët

Banka Evropiane për Rindërtimin dhe Zhvillimin po ndihmon financimin e rehabilitimit të rrugëve dhe projekteve të ndotjeve ujore. Presidenti i Bankës Evropiane për Rindërtimin dhe Zhvillimin, Zhan Lemierrë, vizitoi Sarajevën për të nënshkruar një kredi 75 milion euro për rehabilitimin e rrugëve si edhe të një kredie 7 milion euro për një projekt të ndotjeve ujore për qytetin Bijeljina në Republika Srpska (RS). Nga fondet e rehabilitimit të rrugëve, Federata e Bosnje dhe Hercegovinës do të marrë 45 milion euro, ndërsa pjesa tjetër do t'i shkojë RS.

Zastava e Serbisë do të fillojë të prodhojë Opel Astra në 2008

Automobilbërësi serb Zastava do të prodhojë Opel Astra duke filluar nga viti 2008, sipas një marrëveshjeje me General Motors.

Sipas nënkryeministrit serb Bozhidar Djelić, fabrika në Kragujevac pritet të prodhojë 10,000 Astra Klasiks deri në 2010. Makinat do të shiten në Serbi për rreth 11,000 euro, 2,000 euro më pak se çmimi i tanishëm. Dikur, një nga bërëset e mirënjohura të makinave të lira të Evropës, Zastava pati kohë të vështira me prishjen e Jugosllavisë dhe tani prodhon Fiat Punto.

Turqia dhe Greqia miratojnë marrëveshje për shkëmbimin e energjisë elektrike

ANKARA, Turqi - Ministri i energjisë dhe burimeve natyrore Hilmi Guler dhe ministri grek i zhvillimit Demetris Siufas miratuan të enjten (19 korrik) një pakt për shkëmbimin e elektricitetit dhe të bashkëpunimit për energjinë. Si hap të parë, Turqia do të furnizojë 137 milion kilovat-orë elektricitet në Greqi duke filluar më pas këtë muaj për të ndihmuar konsumin në rritje të energjisë në muajt e verës. Guler theksoi se ndërsa marrëveshja shtrihet deri në gusht, ajo do të riaktivizohet kurdoherë që Greqia të ketë mangut elektricitetin. Një tjetër projekt i madh energjie i diskutuar ishte tubacioni i gazit natyror Turqi-Greqi i cili do të jetë pjesë e korridorit jugor të energjisë në Evropë.

Marrëveshja e përkohshme



Procedurat e nevojshme për fillimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, përveç nënshkrimit të saj nga të dy palët (pala shqiptare dhe institucionet përkatëse të Bashkimit Europian), kërkojnë edhe ratifikimin e kësaj marrëveshjeje nga parlamentet e 25 vendeve anëtare të BE-së. Ky proces ratifikimi është i gjatë dhe kërkon një periudhë prej 2-3 vjetësh. Duke pasur parasysh kohën e nevojshme për të plotësuar procedurat, Komuniteti Europian dhe pala shqiptare nënshkruan një Marrëveshje të Përkohshme "Interim Agreement", zbatim i të cilës ka filluar më 1 Dhjetor 2006 (referuar nenit 135 të MSA-së). Marrëveshja e Përkohshme parashikon krijimin e një zone të tregtisë së lirë mes Shqipërisë dhe BE-së, për një periudhë kalimtare 10 vjeçare. Gjithashtu, ajo parashikon fazat e hapjes së tregut vendas për eksportet e BE-së. Të dyja palët janë angazhuar për të hequr tarifatat doganore për mallrat me prejardhje nga vendet e të dy palëve apo masa të tjera me efekt të njëjtë, ose të reduktojnë në mënyrë graduale tarifatat doganore, deri në zhdukjen e plotë të tyre gjatë një periudhe tranzitore pesë vjeçare të parashikuar në marrëveshje. Kjo përjashton vetëm mallrat e përfshira në listën e produkteve të ndjeshme, tarifatat doganore të të cilave nuk do të ndryshojnë dhe, për

këtë arsye, ato janë lënë jashtë Marrëveshjes. MSA-ja dhe Marrëveshja e Përkohshme, si pjesë përbërëse e saj, mundëson ruajtjen e disa masave penguese në tregtinë e lirë midis palëve me synimin e mbrojtjes së produktit vendas deri në bërjen e tij konkurrues dhe tregun e bashkësisë europiane, deri në zbatimin e saj dhe më pas në anëtarësimin e Shqipërisë në BE, gjë që do të sillte zbatimin e detyrueshëm nga Shqipëria të parimeve të vendosura nga traktatet e BE-së dhe të të ashtuquajturit *acquis communautaire* (tërësia e normave ligjore të BE-së). Në parim, lëvizja e lirë e mallrave parashikon lëvizjen e produkteve me origjinë nga një shtet në një shtet tjetër pa tarifa doganore apo masa me efekt të njëjtë me to. Qëllimi i këtij parimi është eliminimi i barrierave tregtare ndërmjet palëve duke sjellë promovimin e produkteve kombëtare. Liberalizimi tregtar i parashikuar në Marrëveshjen e Përkohshme shkon përtej liberalizimit të ofruar nga palët me instrumente ligjore të njëanshëm dhe gjithashtu merr parasysh marrëveshjet ndërkombëtare ku palët aderojnë. Marrëveshja e Përkohshme pëmban 57 nene, 4 Aneks dhe 5 Protokolle, të lidhura me lëvizjen e lirë të mallrave, konkurrencën dhe dispozitat të tjera ekonomike, ndërmarrjet publike, pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, si dhe dispozitat për transportin.



1 miliard euro mbi Devoll

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për hapjen e tenderit, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve në kaskadën e lumit Devoll. Në projektet e këtyre hidrocentraleve parashikohen të ndërtohen tunele, me një gjatësi të marrë së bashku rreth 50 kilometra. Investimi për këtë projekt shkon rreth 1 miliardë euro. Projekti garanton një shfrytëzim maksimal të potencialit ujor të këtij lumi, një respektim maksimal të luginës në të cilin ai rrjedh. Grupi i oponencës, i ngritur pranë Ministrisë së Ekonomisë, ka shqyrtuar për muaj të tërë projektin e kompanisë për lumin Devoll dhe e vlerëson atë një projekt unik në llojin e tij. Gjithashtu, kryeministri Berisha tha se edhe kompani të tjera të mëdha botërore po tregojnë një interes të madh në rritje, për burime të tjera ujore të vendit. Veçanërisht, Vjosa është më shumë në vëmendjen e tyre. Kryeministri shprehu besimin se gjatë muajve në vijim do të hapet tenderi edhe për këtë projekt. E favorizuar në marrjen me koncesion të hidrocentralit që do të ndërtohet mbi lumin Devoll është kompania "EVN". Qeveria ka miratuar edhe bonusin prej 10 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse që i jepet shoqërisë projektuese (propozim i pa kërkuar) "EVN".

Tender edhe për Hidrocentralin "Egnatia-Shushicë"

Qeveria ka miratuar edhe hapjen e garës për një hidrocentral tjetër. Edhe për këtë hidrocentral, autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore do të jetë Ministria e Ekonomisë. Forma e dhënies me koncesion do të jetë e formës "BOT" (Ndërtim, Operim dhe Transferim) për Hidrocentralin "Egnatia-Shushicë". Edhe për këtë hidrocentral qeveria ka piketuar një kompani të preferuar, e cila ka marrë edhe bonusin. Në mbledhjen e djeshme është miratuar një favor prej 10 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pa kërkuar), që i jepet shoqërisë "Vëllezërit TOLA", sh.p.k.

Dy fabrika çimentoje prej 500 milionë euro

Këshilli i Ministrave miratoi dy vendime, që i hapin rrugën realizimit të dy projekteve në fushën e prodhimit të çimentos, me vlerë prej 500 milionë euro. Këto dy projekte janë realizuar nga kompania greke "Antea Cement" dhe nga kompania spanjolle "Cementos Aguila" dhe parashikojnë ndërtimin e dy fabrikave të çimentos në zonën e Fushë Krujës. Të dy kompanitë kanë përcaktuar sheshet e ndërtimeve për projektet e tyre, për të cilat qeveria miratoi sot ndryshimin e destinacionit të zonës, duke i kaluar ato në zona minerale. Kompania greke "Antea Cement" ka parashikuar për këtë projekt, një investim prej rreth 250 milionë euro. Kjo fabrikë do të ketë një kapacitet prodhues fillimisht mbi 2 milionë ton e më tej do të vijë në rritje. Edhe projekti i kompanisë spanjolle "Cementos Aguila" parashikon një investim prej rreth 250 milionë euro dhe kapacitet prodhues të fabrikës mbi 2 milionë ton si fillim.

Shqipëria, energjia elektrike dhe e ardhmja

Nga ROBERT C. OSTIN

Tranzicioni i Shqipërisë në një vend demokratik bëhet me sakrificë të mëdha nga populli. Fusha më problematike për njerëzit e zakonshëm ka qenë mungesa e vazhdueshme e një furnizimi të qëndrueshëm me energji elektrike. Deri tani, shumica e shqiptarëve e ka pranuar furnizimin e parregullt me energji si një fakt të jetës së përditshme. Çdo vit, shqiptarët thonë se dimri i shkuar ishte më i keqi se çdo vit tjetër. Ky dimër dhe vera e sivjetme janë tejet të vështira me ndërprerjet ditore dhe zhurmën konstante të gjeneratorëve. Megjithatë, mund të duket dritë në fund të tunelit, ndonëse kërkohet ende durim. Nevoja për të projektuar të ardhmen jo vetëm do t' u sjellë lehtësim shqip-tarëve, por do të risigurojë gjithashtu investitorët e huaj të cilët shqetësohen rreth furnizimit të pasigurt me energji. Shqipëria ndeshet me shumë disavantazhe kur vjen puna te prodhimi i energjisë. Ajo varet nga hidrocentralet, pra nga kushtet klimatike. Shqipëria ka përjetuar më pak shi se kurë dhe rezervuarët janë të tharë. Si rezultat i kësaj, vendi mund të përmbushë vetëm 50% të nevojave të tij me elektricitet. Importimi i energjisë është kurdoherë një mundësi, por mundësi e shtrenjtë. Ndërsa vendi detyrohet të blejë energji jashtë, buxheti i shtetit vuan. Pra cila është zgjidhja? Sipas Bojaxhi, duhet ndjekur një numër rrugësh. Së pari, ai është përqendruar në përmirësimin e efektivitetit dhe angazhimin të punonjësve në punën e tyre. Ai po krijon ndërgjegjësime më të mirë të situatës së Shqipërisë nëpërmjet medias së lajmeve dhe më e rëndësishmja, ai ka qenë një përçues i dukshëm i fushatës në orvatjet për të bindur njerëzit të paguajnë energjinë që përdorin. Disa rreth në Shqipëri janë bërë të njohur për shpërfilljen e faturave të pagesave dhe sabotimin e linjave për të përfituar energji pa para. Ndërsa



klientët tregtarë të Shqipërisë kanë gati një rekord të përkryer të pagesave, konsumatorët individualë, veçanërisht në pjesë të Shqipërisë së Veriut, kanë qenë më pak të zellshëm. Rreth 25% e konsumatorëve shtëpiakë nuk paguajnë faturat. Ky është vetëm një hap paraprak. Zgjidhjet afat-gjata që

do ta mundësojnë KESH të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm me elektricitet, janë gjithashtu në tryezë. Për shembull, kompania ka ndërmend të privatizojë linjat e shpërndarjes gjatë dy viteve të ardhshëm. Bojaxhi beson se vetëm kontrolli i sektorit privat mbi shpërndarjen, me një fokus

në rezultatit përfundimtar, mund të përmirësojë gjërat. Një linjë e re transmetimi, midis Elbasanit e Podgoricës do ta bëjë më të mundur importin e energjisë për aq kohë sa mund të paguhet për të. Janë në punë gjithashtu plane për një termocentral në qytetin jugor të Vlorës. Studime

leverdishmërie për një hidrocentral të ri në Bushat të Shqipërisë së veriut janë në proces. Projekte më të vegjël janë gjithashtu të mundshme mbi lumenjtë e shumtë të Shqipërisë. Donatorët ndërkombëtarë kanë dhënë tashmë kontribute të mëdha ndaj përmirësimit të gjërave. Ndërkohë, disa sugjerojnë se rritja e çmimit mund t' i shtyjë njerëzit të kursejnë më shumë. Një mitje e ndjeshme e çmimit u bë vetëm një vit më parë dhe çdo mitje tjetër ka një kosto të madhe sociale për shumë shqiptarë. Rritjet e çmimit mund të vijnë më pas, sapo të garantohet furnizimi. Pa plane për të privatizuar prodhimin, fokusi është në ripërtëritjen e një sive ekzistuese dhe ndërtimin e centraleve të reja. Gjatë dy viteve të ardhshëm do të ketë ende probleme. Investitorët e huaj, që kanë nevojë për energji të qëndrueshme, shpresojnë se një zgjidhje e përhershme e problemit, që ndoshta është nga më të ngutshmit për Shqipërinë, më së fundi po duket.



KRIZA ENERGETIKE

Situata e fundit energjetike që po kalojmë, duket se ka sosur durimin e shqiptarëve, që prej 17 vjetësh kanë vuajtur vazhdimisht pasojat e krizës energjetike. Krizë që ka ardhur është më shumë pasojë e faktorëve, që fare mirë mund të ishin menaxhuar në një dekadë e gjysmë (nëse do të ishin ndërtuar burime të reja energjie dhe shpërndarjeje dhe do të ishte mirë-administruar KESH-i), sesa rrjedhojë e mungesës së reshjeve, që janë në dorë të Zotit (natyrës). Koha ka qenë më se e mjaftueshme për të zgjidhur handikapi mes rritjes së shpejtë të kërkesës për energji pas viteve '90 dhe ofertës së kufizuar. Por sot, fatkeqësisht vazhdojmë të mbështetemi në burimet e energjisë të ndërtuara që para viteve '90, në një kohë që kërkesa është shumë herë më e lartë. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë i Shqipërisë, Genc Ruli paralajmëroi se gjendja e energjisë lokale ishte keqësuar për shkak të thatësisë dhe prodhimit të zvogëluar të hidrocentraleve, ndërsa furnizimet me energji nga jashtë nuk janë në gjendje të përmbushin mungesat. Duke folur në parlament kryeministri Sali Berisha pranoi se po ndodh një krizë energjie dhe tha se problemi është rajonal.